

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "VB Group" Sh.p.k.

Sot, më datë 12 / 02 /2024,

- **"Busy Bee" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS L62123019L, me seli në: Njesia Administrative nr.1, "Rruga "Abdi Toptani", Qendra Tregtare "Toptani Shopping Center", 1001, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë, **Znj. Dorela Sala**.

Në përputhje me **Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"** (i ndryshuar) dhe **Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit"**, ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **"VB Group" Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është **"VB Group" Sh.p.k.**

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Administrative nr.1, "Rruga "Abdi Toptani", Qendra Tregtare "Toptani Shopping Center", Kati 3, Njesia B4,1001, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Blerje shitje veshje per femije.
- Shitblerje aksesore per femije: karroca, krevate, lodra, libra, biberona etj.
- Shitblerje locione per femije: kremra, shampo, vajra etj.
- Transport mallrash brenda dhe jashte vendit si dhe shfrytezimi i menyrave te transportit te cfaredo lloji qofshin keto te tokes, detit dhe ajrit per vete dhe per te tretet.
- Gjithashtu per te realizuar objektin e veprimtarise se saj, Shoqeria **"VB Group"** sh.p.k mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tjetër tregtar e financiar, qe i vlereson te dobishme per arrijten e qellimeve te saj, shitblerje, qeradhenie, qeramarrje, dorezani etj.



- Gjithashtu Shoqëria "VB Group" sh.p.k do të realizojë çdo lloj aktiviteti të ligjshëm që ka lidhje direkte apo indirekte me objektin e veprimtarisë së saj dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.
- Tregtim produkteve dhe shërbimeve të mesipërme me shumicë dhe pakicë drejtëpërdrejt tek klientet ose online në internet (e-commerce).
- Dhënie e ambienteve me qira.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 5.000.000 Lek (pesë milion) Lek dhe është i përbërë nga 1 (një) kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- "Busy Bee" Sh.p.k, zotëron 1 kuotë, që perben 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 5.000.000 Lek (pesë milion) Lek dhe 5.000.000 Lek (pesë milion) Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicën të parashikuara për ndryshimin e statutit.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Znj. Dorela Sala**, shtetase shqiptare, lindur më 01.05.1988, në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr. 032942074 dhe nr. personal I85501095L, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar *Administratorin Znj. Dorela Sala*, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

“Busy Bee” Sh.p.k.

Përfaqësuar nga

Dorela Sala

DORELA SALA

